

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr. 5, paraqitur në KOZ, në datën 03.03.2022”.**

**PJESËMARRJA :**


- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.L.Braho.
- **Stafi KQZ:** Y. Merkaj, E. Mema.
- **Parti Politike:** Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” (A.Kaziaj)
- **Të tjerë:** Bashkia Shkodër (V.Ademi)

**Z. E. Lako:** Atëherë çelim seancën e sotme për shqyrtimin e ankimit nr. 5, të subjektit ankues Bashkia Shkodër, me objekt “kundërshtimin e vendimit nr. 116, datë 02.03.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për shqyrtimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, për zgjedhjet e pjesshme vendore”. Vazhdojmë me verifikimin e palëve pjesëmarrëse. Është i pranishëm subjekti ankues Bashkia Shkodër, e përfaqësuar nga kryetarja, zonja Ademi.

**Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër:** Prezent!

**Z. E. Lako:** Gjithashtu është e interesuar edhe pala e interesuar, përfaqësuesi.

Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*


*Dt.04.03.2022*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Po, zoti Lako, përfaqësuesi i koalicionit "Shtëpia e Lirisë", avokat Altin Kaziaj.

**Z. E. Lako:** Faleminderit! Janë të pranishëm anëtarët e KAS-it. Paraprakisht kemi ndonjë pyetje? Ka ndonjë kërkesë paraprake për ndonjë konflikt interesi? Nuk ka! Gjithashtu edhe administrata e KQZ-së e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i saj, zoti Merkaj. Ftoj zotin Merkaj të na bëjë një përshkrim të shkurtër të rrethanave të ngjarjes.

**Z. Y. Merkaj:** Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar Kërkesa Ankimore nr. 5, datë 03.03.2022, me ankues Bashkia Shkodër, kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me nr. 116, datë 02.03.2022, me objekt shqyrtimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022. Me të ardhur kërkesa ankimore është zhvilluar seanca e shortit, në përfundim të së cilës është zgjedhur relator zoti Elvin Lako. Kërkesa ka kaluar për shqyrtim. Në kërkesën ankimore të paraqitur nga Bashkia Shkodër parashtrohen shkaqet se nuk është dakord me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 116, datë 02.03.2022, për arsye se është shkelur pika 62 dhe 93 e Kodit Zgjedhor, pasi në 12 qendrat e votimit që janë në njësitë administrative Pult, Shosh dhe Shalë nuk ka banorë, janë një numër i vogël banorësh dhe për të mos humbur të drejtën e votës duhet të zhvendoset qendra e votimit nga kjo njësi administrative në njësinë më të afërt, e cila është njësia Rrethinat, e Shkodrës. Pretendimi i Bashkisë Shkodër është se banorët janë mbi 5 km larg qendrave të votimit, rezidentë që janë në Bashkinë Shkodër, kështu që kërkojnë prishjen e vendimit të Komisionerit, pasi prevalon e drejta e votës për të votuar në rastin konkret. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Merkaj! Tek përshkrimi që bëtë mund të kishit thënë diçka për pjesën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pra se si e ka trajtuar këtë çështje përpara, sepse për pjesën se ku e mbështet pretendimin do flasë vetë ankuesja besoj, në qoftë se keni diçka për të shtuar?

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka bërë arsyetimin e vendimit nr. 116, datë 02.03.2022 duke u bazuar në nenin 62, pika 1.4 e Kodit Zgjedhor dhe në nenin 93 të Kodit Zgjedhor ku thuhet, për vendndodhjen e qendrave të votimit, e cila është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe po citoj nenin, pikën 3 të nenit 93: "KQZ-ja mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private ku nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit, ose në një zonë qendre votimi fqinj". Kemi pasur raste që janë lëvizur vendndodhja e qendrës së votimit, por gjithmonë duke qenë nga një qendër votimi në ambientet publike, ku në këtë zonë nuk ka pasur mundësi për ta vendosur qendrën e votimit në ambientet publike, është vendosur në ambiente private. Nuk jemi në rastin konkret të bërë nga Bashkia e Shkodrës, pasi banorët e kanë pasaportizimin në këto njësi administrative dhe Kodi Zgjedhor nuk parashikon që të zhvendosen qendrat e votimit ku janë rezidentë zgjedhësit. Gjithashtu, kemi pasur raste dhe propozime për të bërë qendra votimi lëvizëse, por duke qenë se Kodi Zgjedhor nuk e parashikon, këto nuk janë pranuar. Kështu që duke u bazuar në këto parashikime të Kodit Zgjedhor, Komisioneri ka vendosur të refuzojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndryshimin e vendndodhjes së qendrave të votimit. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Merkaj! Atëherë i japim fjalën ankuesit, zonjës Ademi, për të na paraqitur shkurtimisht se gjatë seancës paraprake ne patëm dhe një debat lidhur me parashtrimet tuaja për shqyrtimin e çështjes në themel, nëse doni t'i referoni edhe njëherë të gjitha është në të drejtën tuaj, faleminderit!

**Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër:** Faleminderit i nderuar, të nderuar! Bashkia Shkodër ka ankimuar përmes ankesës së paraqitur brenda afatit kohor vendimin e marrë, vendimin nr. 116, datë 02.03.2022, të Komisionerit dhe me arsyetimin e moszbatimit të bazës ligjore të referuar në këtë vendim dhe posaçërisht, neni 19, pika 2, neni 62, pika 4 dhe neni 93 pika 2 dhe 3. Në fakt edhe për sa u tha edhe më përpara nga përfaqësuesi, nga administrata e KQZ-së, bazuar në nenin 19 Komisioneri mund të marrë vendime. Sigurisht nuk jemi në rastin e nenit 93, pika 2 dhe 3, ku bëhet fjalë për kërkesën e paraqitur nga Bashkia Shkodër, atë që u tha më përpara, nuk bëhet fjalë për ndryshim të qendrave të votimit, për shkak të ndërtesave private apo publike, apo diçka tjetër. Pra, nuk është kjo kërkesa jonë, nuk bazohet pikërisht në këtë. Kërkesa jonë bazohet në nenin 62, pika 4 dhe dua ta lexoj për të qenë e qartë për të gjithë, e cila thotë: “Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në një adresë me ato të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive apo të paparashikuara në nenin 93, kjo nuk është e mundur”. “Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve”, po e lexoj të plotë, pra nuk jemi as në paragrafin e parë, as në pjesën e parë të fjalisë së dytë, por jemi në rastin, përveç rasteve kur thotë, neni 62, pika 4: “Për shkak të forcave madhore ndryshimi autorizohet vetëm nga KQZ”, po e shtoj fjalën “vetëm”, këtu thuhet “nga KQZ” sepse Kodi Zgjedhor nuk përcakton dikë tjetër, një autoritet tjetër që ta shqyrtojë rastin kur për shkak të forcës madhore, të ndryshohet qendra e votimit. Në fakt në të gjitha kërkesat tona të paraqitura në

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

*Konja*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

data të ndryshme, dhe janë 4 të tilla, ne kemi parashtruar situatën shumë të vështirë në njësitë administrative Pult, Shosh dhe Shalë, përjashtohet këtu vetëm një qendër votimi, ajo e Thethit. Të gjitha qendrat e votimit në këto tri njësi administrative janë të paaksesueshme, që do të thotë për shkak të kushteve të motit, të lagështirës, të ngricës dhe të reshjeve të dëborës që kanë ndodhur dhe para pak ditësh, pritet që të ndodhin dhe të kemi reshje të dëborës edhe në fundjavë, të dielën edhe të shtunën në mëngjes gjithashtu. Unë kam marrë edhe të dhëna të sinoptikës, të *update*-uara edhe para gjysmë ore. Ne parashikojmë që atje të kemi një situatë shumë të vështirë. Është aktualisht sot, imagjinoni pas disa ditësh. Kjo e bën të pamundur aksesin nëpër të ashtuquajturat rrugë, se rrugë nuk janë, në këto njësi. Jo vetëm për ata që banojnë atje, por imagjinoni, thashë jo vetëm ata që banojnë atje, që janë rreth 200 frymë, por imagjinoni për të gjithë banorët që në fakt në momentin aktual që flasim, janë rezidentë në Shkodër, në qytetin e Shkodrës dhe në Rrethina. Në qytetin e Shkodrës ata më së shumti banojnë në lagjet 1 dhe 5, por jo vetëm, dhe në njësinë administrative ka një shumicë më të madhe. Në këto kushte propozimi ynë për të garantuar, sepse në bazë të Kushtetutës të gjithë kemi të drejtën për të zgjedhur, për të marrë pjesë në një proces zgjedhor, dhe aq më tepër në Shkodër tashmë kjo është domosdoshmëri. Me përgjegjësinë që më jep ligji kam propozuar, kam paraqitur shqetësimin tim pranë Komisionerit për situatën që është atje, duke insistuar në një vlerësim të mirë, për të bërë të mundur që të prevalojë interesi për të cilën ne këtu jemi të gjithë bashkë. Është interesi i zgjedhësve, është interesi i Bashkisë Shkodër, mua si kryetare bashkie që jam përgjegjëse për të garantuar dhe jam pjesë e këtij procesi përse i përket organizimit dhe kam dhënë propozimet e mia për të bërë të mundur që zgjedhjet të ndodhin dhe t'u jepet mundësia zgjedhësve që të votojnë. Kështu kam marrë përsipër që të jap disa propozime thjesht për ta orientuar në fakt Komisionerin, për të marrë një vendim, i cili garanton që jo domosdoshmërisht mund

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

të jetë në një ndërtesë private apo publike, kjo nuk ka rëndësi fare për në, e rëndësishme është që të merret në konsideratë situata, shkaqet madhore që ndodhet ai territor dhe për të cilin Komisioneri, bazuar pikërisht në nenin 62, pika 4, të vlerësojë mundësinë e marrjes së një vendimmarrjeje për t'u siguruar zgjedhësve, për të ushtruar të drejtën e votës. Kjo ka qenë kërkesa jonë, kjo vazhdon të jetë kërkesa jonë dhe në vlerësimin tonë pikërisht neni 62, pika 4 nuk është vlerësuar fare nga Komisioneri në vendimin e tij. Pikërisht sepse nuk ka marrë në konsideratë shkaqet madhore të faktuara. Kur them të faktuara, ne kemi dërguar video, ne kemi dërguar pamje reale të datës 22, 23, 24, 27, edhe sot i dërgojmë në qoftë se ka nevojë. Sot po sjellim edhe të dhëna të tjera. Ne kemi 100% reshje thotë sinoptika, që do të thotë nuk i ka marrë në konsideratë në vendimmarrjen e tij. Unë nuk jam teknikene dhe nuk marr përsipër që t'i propozoj vendimmarrje Komisionerit, përkundrazi, unë kam detyrën këtu që të parashtroj situatën e shkaqeve madhore, me të cilat ne përballlemi në këto njësi administrative vetëm me një qëllim, për të bërë të mundur që të gjithë bashkë, që në sajë të një vendimmarrjeje, dhe e kam fjalën këtu për Komisionerin, të sigurojmë të drejtën e votës për të gjithë ata qytetarë atje, prandaj pikërisht duke vlerësuar që Komisioneri nuk e ka bazuar vendimmarrjen e tij pikërisht në nenin 62, pika 4, paraqesim ankesën pranë KAS duke e ankimuar këtë vendim dhe për të bërë të mundur që Komisioneri të marrë një vendim ashtu sikurse duhet. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Faleminderit zonja Ademi, për palën e interesuar, zoti Kaziaj!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Faleminderit zoti relator, të nderuar anëtarë të KAS-it! Fillimisht doja të bëja një hyrje përsa i përket pjesës së

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

moslegjitimit nga ana juaj të kërkesës ankimore bërë në cilësinë e përfaqësuesit të koalicionit “Shtëpia e Lirisë”.

**Z. I. Rusmali:** Kjo është çështje tjetër, kjo nuk mund të jetë objekti ynë.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit “SH-L”:** Jo, është objekti juaj se u shqyrtua nga ju, dhe mosdhënia e të drejtës së ankimit të një interesi të ligjshmëm siç mund të ketë një subjekt...

**Z. I. Rusmali:** Të lutem, kjo është një çështje tjetër. Vendimi është marrë dhe ju keni të drejtën e ankimit në Kolegjin Zgjedhor.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit “SH-L”:** Kërkoj që ky vendim të më njoftohet menjëherë nga ana juaj dhe arsyetimi i këtij vendimi, se mua më duket si jurist, më duket krejt i pambështetur nga asnjë ligj i Republikës së Shqipërisë. Thënë këtë, në cilësinë e kësaj kërkesë të bërë nga kryetarja e Bashkisë Shkodër, kemi shqetësime të theksuara lidhur me mosgarantimin e së drejtës së votës nga institucioni që duhet të garantojë zgjedhjet, pjesë e të cilit jeni dhe ju, në cilësinë e një organi kolegjal vendimmarrës. Pra, me vendimmarrjen e tij, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 116, datë 02.03.2022 me fjalë të tjera, i ka hequr të drejtën e votës, 5773 zgjedhësve të komunave ose njësive administrative Pult, Shalë dhe Shosh. Kjo vendimmarrje nuk ka as logjikë të themi të institucionit për të cilën ne jemi prezent dhe po kundërshtojmë këtë vendimmarrje, por s’ka as dhe logjikë të ligjit. Vetë Komisioneri në seancë publike pak më parë është shprehur që nuk ka pasur dakordësi politike, dhe prandaj është marrë kjo vendimmarrje. Unë dua që nga ky komision të administrohet deklarata publike, të

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

merret në cilësinë e provës, për shkak se vendimmarrja në vetvete nuk ka asnjë logjikë, në të cilën është mbështetur. Thotë që është mbështetur në nenin 93, pika 3, ndërkohë që ligjvënësi ka parashikuar më përpara nenin 62, pika 4, dhe në pikën 1 të nenit 62 është parashikuar qartë se cila është zona e qendrës së votimit. Po ashtu dhe në nenin 2, pika 24 dhe 25 është parashikuar fare qartë duke qenë se një ligj, ose një kod në këtë rast, nuk mund të sqarojë çdo situatë, të çdo neni, togfjalëshi, apo fjale, ligjvënësi në pjesën hyrëse të tij në çdo rast parashikon dhe përkufizimet se çfarë ka dashur të thotë, lidhur me nenin x dhe me nenin y. Tani të nderuar zotërinj të këtij komisioni, ju duket ju e mbështetur një vendimmarrje e tillë, kur në ditët e sotme, një borë e thellë, në zona malore me një infrastrukturë të themi, të paimagjinueshme, të munguar në totalin e saj, në godina që nuk garantojnë as minimalisht kushtet për të ushtruar një proces zgjedhor, i cili do kushte të karakterit teknik, i cili do kushte të karakterit të largësisë për të shkuar tek ato, për shkak se siç e tha zonja Ademi, rreth 70, 80% e banorëve të këtyre zonave jetojnë dhe ushtrojnë jetën e tyre gjatë dimrit në qytetin e Shkodrës. Pra, ne do ju vëmë në dispozicion dhe foto të bëra në momentin e fundit, këto ditë, kur bora ka mbuluar, ka shkuar mbi 1.5 metër, se si do shkojë dhe vetë administrata zgjedhore, e cila ka detyra të posaçme për të dërguar materialet zgjedhore, përfshirë dhe teknologjinë në zgjedhje, që u fut në vitin 2021, se si administrata qendrore zgjedhore do garantojë që anëtarët e qendrës së votimit dhe personi që do jetë përgjegjës për pajisjen PEI, do aksesojnë nga Shkodra për të shkuar në këto zona, në mënyrë që të garantojnë procesin e votimit. Ne këtë gjë e kemi akoma në dyshim dhe në momentin që kemi marrë dijeni mbi vendimmarrjen e Komisionerit, vendimmarrje për të cilën nuk jemi as ftuar në seancë publike, për të thënë kundërshimet tona, ose për të dhënë pëlqimin tonë në rast se do ishte një vendimmarrje ligjore, do duhet të minojmë të gjithë procesin...

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj, se nuk jam i qartë tani, po i referoheni vendimit të mëparshëm, pra ankesës që u bë nga ana juaj, apo po flisni si palë e interesuar të ankesave bërë nga Bashkia Shkodër?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Unë po flas si përfaqësues i koalicioni zgjedhor "Shtëpia e Lirisë".

**Z. L. Braho:** Po, pra por kujt rasti i referohesh, se kur hape fjalën tënde, iu referove një vendimi që u mor në...

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Po, pra ishte paranteza që unë mbylla zoti Braho!

**Z. L. Braho:** Tani po vazhdon si subjekt i interesuar?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Po! Tani kur vetë anëtarët e ZAZ-së 02 në Shkodër, kanë sjellë një vërtetim ku thonë, ne kërkojmë me urgjencë zhvendosjen dhe dërgimin e këtyre qendrave të votimit në një qendër tjetër votimi, në një zonë tjetër, për shkak të kushteve atmosferike. Pse nuk duhet të marrë parasysh Komisioneri një kërkesë kaq legjitime duke minuar vetë procesin zgjedhor? Po në qoftë se në këto zona vërtetohet ai që është shqetësimi ynë i thellë, që nuk ka për t'u bërë një proces zgjedhor, kush do e mbajë përgjegjësinë në këtë rast? Zoti Sekretar ju keni komunikuar me administratën zgjedhore, ju kanë thënë këto shqetësime, do e mbani ju përgjegjësinë në këtë rast, kush do e mbajë përgjegjësinë në qoftë se procesi zgjedhor nuk kryhet në këto zona?

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj keni radhën e pyetjeve tani, mbarove parashtrimet, ke pyetjet? Se duket sikur po e drejton ti seancën këtu.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Zoti Braho, unë kam shqetësimet dhe kërkoj përgjigjet. Duke qenë se nuk isha i ftuar në seancën e Komisionerit dhe sot ju po ma hiqni fjalën, ndërkohë më lini të flas, se kam ardhur këtu për të folur.

**Z. L. Braho:** Ti po flet, por mbaro njëherë parashtrimet, çfarë pretendimesh ke në lidhje me kërkesën e ankuesit.

**Z. E. Lako:** Mbarojmë njëherë parashtrimet dhe pastaj do kalojmë tek pyetjet.

**Z. L. Braho:** Pastaj do të jepet prapë e drejta e fjalës, në qoftë se ti ke pyetje që nuk i bën KAS-i, patjetër që do ia bësh pyetjet administratës dhe kujtdo tjetër.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Po qëndrojmë sipas pëlqimit të zotit Braho, po vazhdojmë në këtë mënyrë zoti Braho. Gjithsesi, unë relativisht tim e bëj sipas një logjike për interesin e koalicionit që mbroj. Pra nuk i garantojmë proces zgjedhor të qetë në bazë të kushteve të caktuara që duhet të ketë një qendër votimi, ose disa qendra votimi, për fillimisht për vetë administratën që do të kryejë detyra zgjedhore atë ditë dhe për votuesit për të cilët jemi të sigurt që në këtë rast do u shkelet një e drejtë kushtetuese, parashikuar në nenin 45, të Kushtetutës. Ne kemi kërkuar me urgjencë që kjo vendimmarrje nëpërmjet, të themi, Komisionit ose KAS-it në këtë rast, kjo vendimmarrje të shfuqizohet në mënyrë të menjëhershme, të ndryshohet vendimmarrja e Komisionerit me nr. 116, datë 02.03.2022.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

Të pranohet kërkesa e palës në këtë rast, të Bashkisë Shkodër duke dhënë autorizimin për ndryshimin e vendndodhjes së qendrave të votimit të kërkuara nga Bashkia Shkodër. Mendojmë dhe vlerësojmë se është i pambështetur totalisht në dispozitat ligjore dhe nënligjore vendimi i Komisionerit. Është marrë jo në përputhje me domosdoshmëritë reale dhe nuk garanton interesin më të lartë të votuesve, të njëjstëve për të cilat me urgjencë është kërkuar ndryshimi i vendndodhjes, dhe për këtë arsye kërkojmë nga ana juaj, duke parë dhe faktin e mospasjes së një kohe fizike në avantazhin tonë, të merren masa duke shfuqizuar këtë vendim. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Kaziaj! Nga anëtarët e KAS-it ka ndonjë pyetje për palën ankuese apo dhe për palën e interesuar, apo dhe për administratën? Po, zoti Çefa!

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Unë kam një pyetje për administratën. Në vendimin objekt ankimi, Komisioneri ka parashikuar që t'i kërkojë zyrtarisht edhe institucioneve shtetërore publike për marrjen e masave për zhvillimin normal të zgjedhjeve në datën 6 mars, konkretisht Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve duke i kërkuar marrjen e masave për aksesimin, për hapjen e rrugës dhe aksesimin e qendrave të votimit dhe po ashtu dhe marrjen e masave për furnizimin me energji elektrike dhe për rrjedhojë dhe me internet për zhvillimin normal të procesit. Pyetja ime është kjo! Janë njoftuar këto institucione dhe si janë njoftuar? U është dërguar një kopje e vendimit apo është hartuar një shkresë e posaçme nga Komisioneri? Dhe e dyta, a ka përgjigje nga institucionet dhe kemi ndonjë informacion nëse masat e kërkuara janë marrë dhe zgjedhjet do të zhvillohen normalisht në datën 6 mars në këto qendra votimi?

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

**Z. Y. Merkaç:** Po, Komisioneri ka dërguar dy shkresa, një OSHEE-së dhe një Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, agjencicë së rrugëve. Nga OSHEE-ja kemi marrë përgjigjen që janë marrë të gjitha masat, bile janë vënë dhe në dispozicion gjeneratorë për çdo qendër votimi, për këto tre njësi administrative, ndërsa nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ende s'kemi përgjigje, por besoj shumë shpejt do të kemi përgjigjen. Mendoj që për internet nuk ka nevojë në qendrën e votimit sepse të gjitha pajisjet janë *off*, nuk janë *on*, nuk punojnë me internet, punojnë vetëm me korent.

**Z. E. Çefa:** Po, faleminderit!

**Z. E. Lako:** Atëherë kam dhe unë një pyetje, ose mund ta ndajmë dhe në dy pjesë për palën ankuese. Ju mendoni që në këto qendra, të cilat janë caktuar për t'u zhvilluar votimet është i pamundur votimi, sipas opinionit tuaj. Ndërsa administrata mendon që është i mundur votimi. Nuk mendoni se argumentet që keni paraqitur para këtij komisioni kanë të bëjnë, jo me një situatë madhore, por me një gjendje të përhershme, le të themi. Listat e zgjedhësve kanë qenë aty, janë ato që janë. Vendbanimi i banorëve të këtyre zonave është ai siç ka qenë dhe në zgjedhjet e kaluara. Pra nuk kemi të bëjmë me një forcë madhore për shkak të lëvizjes së këtyre banorëve në periudhën siç e shpjeguat ju, verë apo dimër, dhe kushtet atmosferike të rënduara janë normale të kësaj kohe, nuk është se jemi përpara ndonjë force madhore dhe në vijim të kësaj logjike, ju mendoni se është e mundur për edhe vetë periudhën për të cilën po flasim, kaq afër zgjedhjeve, që të bëhet zhvendosja e këtyre qendrave të votimit, që do kërkojë kohë, angazhim, njerëz, struktura, njoftimin e banorëve për ndryshimin e qendrës së votimit, shpalljen e listave? Jemi përpara një kohe fizike ku të gjithë afatet që parashikon ligji për kriteret që duhet të plotësojë

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

një qendër votimi, nuk mund të plotësohen më tashmë. Faleminderit! Kjo është dhe për palën e interesuar në qoftë se do të na ndihmojë, ose të bashkohet.

**Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër:** Ju faleminderit! Në fakt në situatën që jemi sot, është e vërtetë që ajo që ju thoni që gjatë periudhës janar, dhjetor, shkurt, mars, situata atje është e paaksesueshme, që do të thotë, ka shumë pak njerëz që jetojnë atje dhe gjithë të tjerët jetojnë në Shkodër. Marrin shërbimet administrative në Shkodër, shkojnë në shkollë fëmijët në Shkodër, marrin ndihma ekonomike, KEMP-in, pagesat e paaftësisë, gjithçka. Edhe zyrat e njësisë administrative gjatë kësaj periudhe, administrata vendore gjatë kësaj periudhe funksionon në Shkodër dhe jo rastësisht sipas propozimeve që ne kemi sjellë, funksionojnë pranë godinës së Njësisë Administrative Rrethina. Por jemi në kushtet që nuk ka ndodhur ndonjëherë më përpara që të kemi zgjedhje në muajin mars. Zakonisht kemi zgjedhje në pranverë, verë, kjo ka ndodhur gjithmonë në Shkodër dhe në gjithë Shqipërinë. Në këtë kontekst, situata që paraqitet atje dhe aksesit i pamundur, ju thatë që është i pamundur votimi, unë them që është i pamundur aksesit, e për rrjedhojë, pasojë është i pamundur votimi. Pra, është i pamundur procesi, është i pamundur duke marrë parasysh se edhe me helikopter do i çojmë komisionerët. Me çfarë do i çojmë njerëzit, me çfarë do shkojnë njerëzit? Transporti ka një linjë në fakt të miratuar të transportit nga Bashkia Shkodër, por që nuk shkon dot, sepse situata atje është rruga dhe territori është i paaksesueshëm. Kjo për shkak të, ne e kemi pastruar për shembull borën para dy ditësh, por ka rënë prapë dhe prapë do bjerë ditën e shtunë dhe të diel dhe është e pamundur, dhe nuk po flas vetëm për aksin kryesor që shoqëron të gjitha njësitë administrative. Lidh Pultin, Shoshin dhe Shalën, por palën këtu mënjano faktin që do duhet të shkohet në Bruçaj, do duhet të shkohet në Lotaj. Do duhet të shkohet pra në të gjitha qendrat e votimit, fshatrat që kanë rrugë

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

të tjera të fshatit që janë edhe më keq sesa kjo rruga që unë po flas, që është kjo rruga kryesore. Në këtë kontekst bëhet i pamundur aksesit. Ndoshta do të ishte më e thjeshtë sikur banorët të jetonin atje gjatë kësaj periudhe, pra të dimëronin atje. Në fakt gjatë 3-4 muajve ata dimërojnë në Shkodër dhe kthehen atje në vendbanimet e veta për të gjithë pjesën tjetër të vitit. Tashmë edhe më shumë dhe për turizëm, sepse ka filluar të jetë një zonë që frekuentohet gjithnjë e më tepër. Kjo e bën të pamundur dhe të vështirë, të rrezikshëm, e them të rrezikshëm edhe për të gjithë ata që mund të guxojnë të shkojnë, sepse udhëtimi me mjete në atë rrugë është i rrezikshëm, është i rrezikshëm në verë, imagjinoni në situatën në të cilën ndodhemi. Në shumë nga kthesat ku nuk bie dielli, atje është i pamundur edhe kur nuk bie borë kalimi, sepse ka ngrica dhe ka një situatë shumë të vështirë të rrugës. Kjo mendoj që është mjaftueshëm për të kuptuar situatën reale në njësitë administrative Shosh, Shalë dhe Pult. Përrjashtohet vetëm fshati Theth, qafa e Thethit. Ndërkohë ndër 5773 zgjedhës, 200 banorë, se duhet të verifikoj tani sa zgjedhës janë, jetojnë në njësitë administrative, të tjerët aktualisht janë rezidentë të përkohshëm në Shkodër. Dhe për të vajtur tek qendrat e votimit nuk është se duhet të bëjnë as 800 metër, as një mijë metër, as 5 mijë metër, por duhet të bëjnë 60 km rrugë të tmerrshme në ngrica dhe me dëborë. Ata nuk e bëjnë sot edhe për arsye ndoshta të ekstremit të nevojës familjare, se mund të ketë dhe të tilla, dhe kur kemi pasur nevojë në fakt dhe për emergjencë shëndetësore, që mund të kemi pasur, ne dërgojmë mjete të rënda, përdorim edhe ushtrinë, përdorim edhe FNSH-në, kemi përdorur edhe helikopterin. Dhe kjo ka ndodhur rëndom, pa pasur as situatë të jashtëzakonshme në Shqipëri, apo jo? Imagjinoni t'i ftojme ata për të vajtur për të ushtruar të drejtën e vet për të zgjedhur, që është një e drejtë e tyre sigurisht, por që shprehet përmes një vullneti, por në kushte normale të jetës normale. Duke i vendosur këtë barrierë, që është goxha e madhe, me 100% probabilitet, u kemi hequr atyre të drejtën për të zgjedhur


*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

dhe për të ushtruar të drejtën e vet. Prandaj unë kam insistuar duke dhënë dhe duke guxuar pastaj të jap dhe disa propozime, pavarësisht se nuk është, ndoshta unë kam tejkaluar në këtë rast, por kam dashur t'i jap një shembull Komisionerit për të marrë një vendim të arsyetuar bazuar në kushtet ekstreme, në të cilat ndodhet territori atje, dhe duke e argumentuar pikërisht edhe me faktin që është më e lehtë për të gjithë banorët, për të vajtur tek qendrat e votimit që i kanë tek vendi, ku janë aktualisht duke jetuar, sesa të marrin rrugat, themi ne në Shkodër, dhe të bëjnë kilometra në ngricë, në dëborë dhe me risk shumë të madh. Lidhur me njoftimin e banorëve është më lehtësisht e menaxhueshme të njoftosh banorët, sesa t'u çosh qoftë edhe një komisioner atje me pajisjet e sigurta, të menaxhosh gjithë procesin atje edhe të kthehen të gjithë të sigurt, duke përfshirë këtu edhe zgjedhësit. Administrata vendore është atje, e pranishme. Ne mund të marrin përsipër në fakt që të bëjmë njoftimet përkatëse edhe për dy ditë kohë, sepse thashë edhe njëherë, ka një kompaktësi, mund të përdorim edhe median në këtë rast, e cila mund të vihet në dispozicion pikërisht për këtë fakt. Dhe kështoj unë mendoj që edhe për verifikimin e listave të votuesve, për të gjithë ata që duan të votojnë, është më e thjeshtë t'u bëjmë *check* tek njësi administrative afër vendndodhjes së tyre, kontroll emrit të vet, sesa të marrin rrugët edhe të bëjnë 68-70 km për të verifikuar qoftë dhe emrin e vet në listë, është më e thjeshtë. Në qoftë se flasim për një administrim të thjeshtë të një procesi zgjedhor për të siguruar njoftimin edhe informacionin. Unë kështu e kam vlerësuar dhe mendoj që me përgjegjësi e them që ne do duhet të bëjmë gjithçka që t'u sigurojmë banorëve tanë, qytetarëve tanë, të drejtën e votës. Për këtë mendoj që ata e gëzojnë këtë të drejtë me Kushtetutë, por nga ana tjetër ne të gjithë duhet t'ua sigurojmë atë. Nuk mundemi, për arsye që janë jo të tonat, por arsye të një infrastrukture të trashëguar të tmerrshme, por edhe për kushte ekstreme të motit. Më datën 6 ka 100% reshje, të dielën dhe të shtunën gjithashtu. Pra mund të agravohet dhe më tej sesa

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

unë e them dhe për faktin se udhëtimi nëpër atë rrugë është i rrezikshëm në verë, imagjinoni në këtë situatë. Mendoj që vlen që të vlerësohet dhe do duhej të ishte vlerësuar nga Komisioneri si fakt, dhe si ngjarje që të mund të merrte një vendim, më të duhurin e mundshëm. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Faleminderit zonja Ademi! Zoti Kaziaj keni diçka?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Thjesht për faktin që janë bërë të gjitha përpjekjet nga ajo që ligji njih si detyrim kryetares së bashkisë lidhur me këtë emergjencë, ose këtë forcë madhore, dhe ne shpresojmë në vendimmarrjen tuaj për shkak dhe të afatit siç e thatë ju, kaq të shkurtër, të pyetjes që i bëtë kryetares së bashkisë, fakti është që interesi më i lartë i tyre është më mirë që të kemi një zhbërje të vendimmarrjes së Komisionerit dhe i ndryshim-vendndodhjes së këtyre QV-ve dhe për impenjimin, për njoftimin e të gjithë zgjedhësve do vihet në lëvizje gjithë makineria e Bashkisë Shkodër dhe institucionet përkatëse që detyrohen nga ligji, ose ngarkohen nga ligji me detyra të posaçme në administrimin e vetë procesit zgjedhor. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Kaziaj! Ju e keni parasysh, jo për debat, por që këto gjëra janë disa procedura dhe afate që përcaktohen nga ligji pavarësisht dëshirës dhe vullnetit të aktorëve pjesëmarrës. Po, zoti Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Se më lindi pyetja nga ajo që tha përfaqësuesi i subjektit. Çfarë detyrash konkrete ka bashkia në raport me përgatitjen për votim të qendrave të votimit? Çfarë bën konkretisht për këtë punë?

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

**Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër:** Ne i kemi dërguar informacion për detyrimin që kemi më datën 28.01.2022 Komisionerit lidhur me detyrimet tona për të siguruar procesin zgjedhor që lidhet me infrastrukturën. Bëhet fjalë për shkresën me nr. 1165/1, datë 28.01.2022, ku ne e informojmë Komisionerin për të gjitha qendrat e votimit lidhur me, është ambient publik apo privat, çfarë sipërfaqe ka, ka dritare, dyer, aksesit me rrjetin elektrik, nëse ka apo jo, kati, rampa apo jo, dhe infrastrukturën e brendshme të qendrës së votimit. Ky është detyrimi ynë dhe ne këtë e kemi bërë me shkresë.

**Z. I. Rusmali:** Domethënë ky është detyrimi dhe ka lidhje me momentin kur caktohen qendrat e votimit. Ju informoni KQZ-në që janë caktuar këto qendra të votimit dhe këto qendra votimi plotësojnë kushtet e tyre të brendshme për të funksionuar si të tilla.

**Z. Y. Merkaj:** Neni 52 i Kodit Zgjedhor, “Detyra e kryetarit të bashkisë për të njoftuar zgjedhësit”.

**Z. I. Rusmali:** Çfarë detyre përcakton?

**Z. Y. Merkaj:** “Brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit” thotë, po citoj nenin, “të përbërësve zgjedhorë, sipas pikës 1,2,3 nenit 51, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kryen lajmërimin me shkrim të çdo zgjedhësi të përfshirë në ekstrakt të përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit...”.

**Z. I. Rusmali:** Lajmërimi me shkrim është gjë tjetër, po diskutojmë për objektin fizik. Jemi duke diskutuar për përgatitjen e objektit fizik për zgjedhje. Kryetarja e

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

bashkisë ka caktuar qendrën e votimit dhe ka informuar që këto plotësojnë kushtet për votim, qendrat e votimit dhe këtu mbaron detyra e kryetarit të bashkisë. Pjesa tjetër, pra situata, reshjet, aksesit, janë angazhimet tuaja qytetare, por jo për shkak të funksionit. Si të thuash, ju ligjërisht i keni dorëzuar këto qendra votimi dhe keni thënë këtu mund të zhvillohen zgjedhjet. KQZ-ja i ka pranuar këto qendra votimi?

**Z. Y. Merkaç:** Po!

**Z. E. Lako:** Faleminderit!


**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Në qoftë se mundem zoti Rusmali dhe për shkak të funksionit, kryetari kërkon autorizim pavarësisht se në një moment fillestar, nga dalja e dekretit të Presidentit, dhe nga ushtrimi i funksionit të saj, ajo dërgon pranë KQZ-së të gjitha ato që listoi, një moment që ndryshon, po themi, situata, kryetarja e bashkisë...

**Z. I. Rusmali:** I referoheni nenit 62, paragrafi 4? Për këtë jam i qartë!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Kërkon autorizim kjo, në këtë rast.

**Z. I. Rusmali:** Për këtë jam i qartë. Çështja është për detyrat konkrete që ka kryetari i bashkisë në raport me përgatitjen. Kuptova që detyrat konkrete, në fakt nga momenti i caktimit u përkasin institucioneve të tjera që duhet të marrin masa që gjërat të funksionojnë. Në institucionet e tjera, siç thotë sekretari i KQZ-së, njëri ka konfirmuar që do të funksionojë përsa i përket energjisë elektrike, tjetri pritet të konfirmojë aksesueshmërinë.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

**Z. E. Lako:** Atëherë nëse s'ka ndonjë pyetje tjetër kalojmë tek konkluzionet përfundimtare. Shkurtimisht çfarë kërkoni nga ky komision zonja Ademi, me radhë?

**Znj. V. Ademi, kryetare e B. Shkodër:** Duke parashtruar kërkesën time e kam shënuar dhe në ankesën që kam bërë. Në përfundim, duke pasur parasysh kushtet klimatike të paqëndrueshme dhe gjendjen e akseve rrugore për shkak të këtyre kushteve, në zonat ku ndodhen aktualisht qendrat e votimit në Shalë, në Pult, Shosh, Bashkia Shkodër vlerëson se KAS duhet të marrë në shqyrtim rrezikun që paraqet mungesa e sigurisë së udhëtimit për qytetarët në fshatrat e njësisve Shalë, Shosh dhe Pult, pasojë kjo që do të pengojë qytetarët për t'iu drejtuar qendrave të votimit e për rrjedhojë kjo do të përbëjë cenim të së drejtës së tyre për të zgjedhur, arsyetim ky që përbën shkak madhor, i cili nuk është arsyetuar nga Komisioneri dhe me vendimin e vet ka marrë një vendim të gabuar që nuk bazohet pikërisht nga neni 62, pika 4.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Në mendimin tonë, i nderuar zoti relator, të nderuar anëtarë, Komisioneri ka devijuar totalisht dhe që është fryma e ligjit dhe këto që janë dispozita përkatëse që ligjvënësi garanton nëpërmjet Kodit Zgjedhor të drejtën kushtetuese të zgjedhësve për të zgjedhur. Totalisht, të themi në këtë rast e ka devijuar duke mos u mbështetur në një dispozitë ndaluese në këtë rast, nuk ka një dispozitë ndaluese. Ka dispozita qartësuese, ka dispozita të interpretueshme, por në këtë rast, të themi, interesi madhor i 5773 zgjedhësve nuk mund të dalë mbi tekat e një subjekti politik, nëpërmjet të cilit nuk është arritur dakordësia. Jua thashë është deklaratë publike, mund ta administroni në vendimmarrjen tuaj. Një subjekt politik nuk mund të ketë teka për mosarritjen e dakordësisë duke minuar procesin zgjedhor në vetvete.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.04.03.2022*

**Z. E. Lako:** Zoti Kaziaj pa dashur t'ju ndërpres, pavarësisht se ju ndërpreva, ju lutem jemi tek konkluzionet përfundimtare, mos t'u hyjmë deklaratave apo argumenteve që nuk janë shqyrtuar fare gjatë...

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Është pjesë e konkluzioneve.

**Z. E. Lako:** Por nuk është shqyrtuar pjesa se çfarë mendojnë subjektet politike, nuk e kemi shqyrtuar në asnjë moment të kësaj çëshjeje.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Duhet ta... në mendimin tonë.

**Z. E. Lako:** Por mund ta kishit ngritur nëse do ta quanit, nuk e ngritët.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Ja pra, jemi në seancë tek ju i nderuar zoti Lako, po e ngremë në këtë moment.

**Z. L. Braho:** Janë konkluzionet tani. Nuk administrohen provat tani!

**Z. E. Lako:** Megjithatë mund të mbarosh!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Ju administroni çfarë të doni zoti Braho, se ju e paragjykuat që në fillim, që në momentin e hapjes së fjalës time. Ju administroni çfarë të doni! Të drejtën e fjalës për dy minuta të lutem ma jepni!

**Z. L. Braho:** Mirë, meqenëse e ke të drejtën e fjalës, të lutem na sqaro, meqenëse je palë e interesuar, çfarë kërkon konkretisht nga KAS-i, sepse vetëm shfuqizimi i

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*


*Dt.04.03.2022*

vendimit të Komisionerit kërkohet? Çfarë zgjidhje sugjeroni ju? Pra, kush është zgjidhja që ju sugjeroni bashkë me ankimin?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Po, i nderuar! Ju e keni domethënë, do jua jap dhe në dispozicion, fakti është që jemi futur në cilësinë e palës së interesuar dhe unë në cilësinë e palës së interesuar po mbroj palën ankuese. Duke qenë se pala ankuese ka kundërshtuar këtë vendimmarrje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe ne forcërisht e kundërshtojmë atë, duke minuar kjo vendimmarrje procesin zgjedhor dhe të drejtën kushtetuese të zgjedhësve. Përfundimisht kërkojmë zoti Braho, mbështetur nenit 30, pika 1, germa "c", të vendimit nr.3/2020 të Komisionit Rregullator, ndryshimin e vendimit nr.116, datë 02.03.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pranimin e kërkesës, dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes të qendrave të votimit sipas kërkesës të bërë nga kryetarja e Bashkisë Shkodër në ato që kanë qenë objektet e listuara për ndryshimin e vendndodhjes.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Kaziaj! Atëherë KAS do tërhiqet për vendim. Në orën 14:15 do rimblidhemi përsëri. E deklaroj të mbyllur mbledhjen.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

**Rifillon seanca**

**Ora 14:13**

**Z. E. Lako:** Atëherë, për të gjitha arsyet që shpjeguan dhe për të gjitha faktet që dolën gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, në mbështetje të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 143 të Kodit Zgjedhor, KAS vendosi:

1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 5, datë 03.03.2022, të paraqitur nga Bashkia Shkodër.
  2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 116, datë 02.03.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
  3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.
- Seanca deklarohet e mbyllur!

**Vendim nr. 11**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

